



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM

VENDIM

Nr.10, datë 17/07/2024

PËR

**MIRATIMIN E “KËRKESË PËR RINOVIMIN E KUSHTEVE TË LEJES” PËR PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE, LEJE ME NR.SERIE 00032, MIRATUAR NGA KBU ISHËM-ERZEN ME VENDIM NR.13, DATË 20.09.2019 HEC “MALI”, TË SHOQËRISË “TIRANA ENERGJI” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim energjie elektrike me Nr.serie 00032, miratuar nga KBU Ishëm me Vendim Nr.13, datë 20.09.2019 HEC “Mali”, subjektit “Tirana Energji” sh.p.k., me vendndodhje, në rrjedhën e ujit të patrajtuar të tubacioneve të ujësjellësit Bovillë, lumi Tërkuzë, Bashkia Tiranë, Qarku Tiranë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit uJOR

## HEC "MALI"

Vepra e marrjes

- $X=488785.8$
- $Y=4589938.3$
- $Z=303\text{ m}$
- $Q_{mes}=3.14\text{ m}^3/s$
- $Q_{llog}=3.5\text{ m}^3/s$
- $Q_{eko}=0.093\text{ m}^3/s$

## Godina e Centralit

Pika e shkarkimit

- $X=488690$
- $Y=4589869$
- $Z=246\text{ m}$
- Fuqia max e instaluar  $N=1.490\text{ MW}$
- Energjia Vjetore  $E=8,715623\text{ kWh/vit.}$

3. Zbatimi i lejes nuk duhet të pengojë prodhimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm të popullatës, plotësimin e nevojave për ujitje, sipas kërkesave të organeve të vetëqeverisjes vendore, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Të respektojë kushtet e përcaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.
5. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

**KRYETARI I KBUI SHËM**

**EMILJAN JANI**

